



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
KUVENDI KOMUNAL ASSEMBLY OF MUNICIPALITY SKENDERAJ	
Nr.	11-052/01-0001325/26
No.	
Data.	
Data.	09.01.2026



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

DATË/A:	09.01.2026
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
CC:	Zyra për Informim
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Arkivës
NGA/OD/FROM:	Udhëheqësi i Sektorit për Kulturë, Rini dhe Sport Z.Faton Zekaj
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport i punës për vitin 2025 - Sektori për Kulturë Rini dhe Sport



Raport i punës i Sektorit për Kulturë Rini dhe Sport gjatë vitit 2025

10 janar – përmes web faqës së Komunës së Skenderajt është bërë Thirrja Publike për Projekte/Programe në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

-17 Shkurt - Dita e Pavarësisë së Kosovës. - Më shënimin e kësaj date Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport kanë bërë homazhe në Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz dhe Kompleksin Memorial në Morinë. Seancë solemne e Kuvendit Komunal. Turnir në basketboll dhe gara sportive.

- 24 Shkurt – është publikuar raporti vlerësues me listen e perfituesve të subvencioneve me thirrjen e parë publike për vitin 2025, nga kjo thirrje kanë perfituar gjithsej 27 aplikant nga 33 sa ishin gjithsej, 12 në fushën e sportit, 7 në fushën e kulturës, 8 në fushën e rinisë.

-28 Shkurt - 27 vjetori i Betejës së Qirezit dhe Likoshanit - Kjo datë tash e disa vite është duke u shënuar në bashkëpunim me Komunën e Drenasit.. Këto dy komuna së bashku kanë bërë homazhe të varrezat e dëshmorëve dhe martirëve të rënë në betejën e Qirezit dhe Likoshanit.

-5, 6 dhe 7 Mars -26 vjetori - EPOPEJA E UÇK-së, java kulturore “Jetojmë me Lavdinë Tuaj”. Në kuadër të kësaj jave në komunën tonë u zhvilluan disa aktivitete kulturo-sportive tashme tradicionale.

- 5 Mars – Është mbajtur seancë solemne nga kuvendi komunal i Skenderajt, në nderim të sakrificës së Jasharëve me 5, 6 e 7 mars të vitit 1998.

- 5 Mars - Ora e parë e mesimit i kushtohet Epopesë se Jasharajve

Homazhe perkujtimore në kompleksin memorial Adem Jashari dhe në Morine

- 6 Mars - Kemi qenë nikoqir i parakalimit të mbi 100 automjeteve ” **Off –Road** ” ku kanë marrë pjesë shumë autoklube të qyteteve të Kosovës në itinerarin Skenderaj- Prekaz- Bjeshka e Moknës Istog.

- 7 Mars

Përmbledhja e aktiviteteve zyrtare në shënim të Epopesë së UÇK-së, me pjesëmarrjen e gjerë të personaliteteve të jetës politike, kulturore dhe qytetarë të shumtë. Nga ora 19:30 në Komunën e Skenderajt u mbajt manifestimi „ Nata e Zjarreve”, në orën 19:00 të varrezat e dëshmorëve në Kompleksin Memorial në Prekaz u ndezën flakadanët, rit ky tradicional dhe më pas në sheshin “Adem Jashari” u mbajt një koncert me këngë dhe valle. Në këtë koncert morën pjesë këngëtarë të estrades muzikore si dhe Ansambli shtetëror “ Shota “ , dhe dy ansamblet shtetërore të Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë.

18 Mars – Ceremonia madhështore e përcjelljes së babait të presidentit Hashim Thaçi për në botën tjetër i organizuar nga Komuna e Skenderajt dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport për tre ditë radhazi.

-24 Mars – Është mbajtur maratona Vrapimi i Marsit - Izbica

-26 Mars - Avancimet Kulturore “ Profesor Ajet Beqiri 2025 “

Është mbajtur aktiviteti kulturor, Avancimet Kulturore “Prof. Ajet Beqiri “2025, i organizuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport. Ky organizim tashmë tradicional, ka karakter garues për nxënësit e shkollave fillore në dy fusha: Letërsi dhe Art Figurativ. Në të dy fushat juria profesionale zgjodhi më të mirët në mesin e shumë të mirëve. Në fushën e letërsisë ishin gjithsej 143 punime, edhe në fushën e Artit Figurativ kishte 28 konkurent këtë vit, e që për të dy juritë ishte e vështirë të bënin perzgjedhjen e tyre për fituesit.

Çmimet në fushën e Letërsisë janë:

Ese

1. Çmimi i parë - Agnesa Malaj , Shfmu “ Malush Ahmeti” Rezallë (50 euro)
- 2 . Çmimi i dytë-Tijara Konjuhi , Shfmu “ Ahmet Delia” Skenderaj (35 euro)
3. Çmimi i tretë - Learta Tahiri, Shfmu “ Idriz Barani “ Klinë e Epërme (25 euro)

Poezi

1. Çmimi i parë-Bleron Balaj, Shfmu “Ahmet Delia” Skenderaj (50 euro)
2. Çmimi i dytë- Klea Koca , Shfmu “ Drenica ” Polac (35 euro)
3. Çmimi i tretë- Leonora Lani , Shfmu “ Halit Geci” Llaushë (25 euro)

Çmimet në fushën e Artit Figurativ janë:

Vizatim

1. Çmimi i parë- Vlera Lushtaku, Shfmu “Shaban Jashari “ Skenderaj (50 euro)
2. Çmimi i dytë- Tuana Azizaj , Shfmu “ Idriz Barani” Klinë e Epërme (35 euro)
3. Çmimi i tretë-Inesa Lushtaku, Shfmu “ Ilir Lushtaku” Prekaz i Ulët (25 euro)

Pikturë

1. Çmimi i parë -Ledijon Veliqi, Shfmu “ Drenica” Polac (50 euro)
2. Çmimi i dytë- Vlera Beqa , Shfmu “ Abedin Rexha ” Turiçec (35 euro)
3. Çmimi i tretë- Elfije Lushtaku , Shfmu “ Rifat Mëziu “ Skenderaj (25 euro)

Falenderojmë dhe familjen e Profesor Ajet Beqiri për bashkëpunimin dhe setin e librave që i dhuroi shkollës fituese.

Në këtë aktivitet moren pjesë 370 persona, vlenë të theksohet se ishte aktiviteti me më shumë nxënës pjesëmarrës dhe në publik se sa në vitin e kaluar.

28 Mars – Masakra e Izbicës - U mbajt tubim perkujtimor në kujtim të 26 vjetorit të masakrës së Izbicës ku mbetën të vrarë 147 civil të pafajshëm. Në këtë tubim morën pjesë krytari i komunes, drejtor, zyrtarë dhe shumë qytetar për të nderuar dhe kujtuar viktimat kishte dhe disa fjalime rasti. Në këtë tubim perkujtimor morën pjesë afërsisht 850 - 1000 persona.

Është bërë edhe zbulimi i Pllakës perkujtimore në shtëpinë e Afrim Xhemajlit, e cila ka sherbyer si furrë buke e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

-05 Prill - Përkujtohet masakra e Rezallës

Në përkujtim të 26-vjetorit të masakrës së Rezallës u mbajt tubim perkujtimor dhe u bënë homazhe dhe nderime pranë Kompleksit të varrezave në Rezallë. Në këtë aktivitet morën pjesë strukturat e nivelit lokal, deputet dhe shumë qytetarë.

-30 Prill - Përkujtohen Komandanti Ilaz Kodra në 26-vjetorin e rënies së tij, si dhe 40 dëshmorët dhe 275 martirët e Drenicës. U bënë homazhe dhe nderime institucionale tek Kulla e heroit Ilaz Kodra në Prekaz po ashtu homazhe dhe nderime në Kompleksin e Varrezave të Dëshmorëve në Marinë dhe Verboçë ku dhe ka rënë Komandanti Ilaz Kodra

Është mbajtur Turneu memorial “Ilaz Kodra” në futboll. Ku morën pjesë rreth 250 persona.

- 13 Maj - Homazhe në shënimin e përvjetorit të rënies së Dëshmorëve Tahir dhe Nebih Mehës në Prekaz.

- 04 Qershor - Nën organizimin të DKRS-së përkatësisht, Sektori për Kulturë në kuadër të Ditës së Çlirimit të Skenderajt, më 4 qershor u mbajt edicioni i tetëmbdhjetë i Festivalit Gjithëkombëtar Teatrot Shkollore " Drenushat " Skenderaj 2025.

Pjesëmarrja ishte e kënaqshme. Në këtë festival u ndanë edhe çmime për më të mirët, nga juria profesionale. Në këtë festival morën pjesë SHFMU-ta.

Festivali u mbajt më 4 qershor 2025. Numri i nxënësve pjesëmarrës në gara në këtë festival ishte mbi 100 nxënës, ndërsa të njëjtat u përcollën nga një numër i nxënësve dhe prindërve rreth afër 400 persona

gjithsej.

Shfaqjet e festivalit u vlerësuan nga juria profesionale dhe u ndanë mirënjohje dhe çmime.

Edicioni i 18-të me radhë, i organizuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

Pas paraqitjeve të shfaqjeve teatrale, juria profesionale ka vlerësuar dhe përzgjedhur shfaqjet më të mira, duke i shpërblyer me çmime dhe mirënjohje. Shfaqjet u vlerësuan në këtë mënyrë:

1. Drama më e mirë „ Magjia e fjalës ” nga shkolla „ Azem Bejta “ Prekaz i Epërm.
2. Regjia më e mirë shfaqja “ Fuqia e Mujit” nga shkolla “ Ismet Rrahmani “ - Aqarevë.
3. Skenografia më e mirë shfaqja „ Lulja dhe Shëga” nga shkolla “ Abedin Rexha “ - Turiçec.
4. Çmimi i publikut shfaqja „ Mamaja që i kujton sakrificat fëmijes ” nga shkolla „ Ahmet Delia “ - Skenderaj.
5. Aktori më i mirë - Aulon Lushtaku me shfaqjen “ Vëllazëri e interes “ nga shkolla „ Ilir Lushtaku “ Prekaz i Ulët.
6. Aktorja më e mirë Orneta Velu me shfaqjen “ Audicioni Familjar “ nga Teatri për fëmijë “ Kaçurrelat “ Skenderaj.

Shfaqjet u vlerësuan nga juria profesionale që e kishte këtë përbërje: Albert Deliu- Aktor, Mujë Xhekaj- aktor dhe Arbësa Azemi- aktore.

Falenderojmë të gjitha shkollat përmarrëse për angazhimin dhe punën e tyre!
DKRS- Komuna Skenderaj.

-18 Qershor 2025- Dita e Çlirimit të Skenderajt- Me shënimin e kësaj dite Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport bëri, homazhe në Kompleksin Përkujtimor në Prekaz, homazhe në Varrezat e Dëshmorëve në Morinë.

Është mbajtur Akademi Përkujtimor me rastin e 18 Qershorit si Dita e Dëshmorëve dhe Martireve të Komunes së Skenderajt në Qendrën e Kulturës “ Hasan Prishtina” ku moren pjesë rreth 500 të ftuar. U organizua edhe një koktej rasti me familjet e dëshmorëve. Ceremonia e shpalljes qytetar nderi të dy figurave shumë të rëndësishme Benito Mares dhe Vaughan Smith.

Është zbuluar shtatorja e heroines ‘Nëna Zahide’ në institucionin parashkollor me po të njëjtin emer me një ceremoni mjaft mirë të organizuar ku moren pjesë rreth 500 (pesëqind) qytetar, ekspozitë me fotografi të nxënësve nga Shkolla Shaban Jashari punuar nga mesuesja Fatlume Mehmeti dhe perkratur nga DKRS-ja. Inaugurimi i emrit të shkollës “Rifat Mëziu “. Dhe në fund Koncerti për fëmijë dhe të rritur i mbajtur po në shesh ku kishte një pjesë të kenaqshme të publikut.

29 Qershor 2025- është mbajtur një operë me pesë akte nga artisti Petrit Halilaj nën qiellin e hapur në fshatin e tij të lindjes në Syrikanë i titulluar Syrigana, kishte mjaft pjesëmarrës nga niveli lokal dhe qëndror.

Muzeu

-Gjatë muajit Qershor-Korrik në Muzeun e qytetit e kanë vizituar edhe shumë vizitore nga mërgata dhe nga niveli lokal po ashtu edhe shumë shkolla nga Republika e Kosovës dhe Komuna e Skenderajt.

Arkiva

Në Arkivin Historik Komunal në Skenderaj, janë kryer punët dhe detyrat e punëve sipas planit të punës e që janë në fushëveprimtarinë e këtij institucioni të rëndësishëm kulturore, siq janë:

-Ruajtja, mbrojtja dhe sistemimi i materjaleve arkivore komunale.

- Evidentimi dhe inventarizimi i dokumenteve historike

-Digjitalizimi i fondeve arkivore

- Shërbimi ndaj qytetarëve dhe institucioneve etj.

Përveç punës profesionale rreth ruajtjes dhe mbrojtjes së dokumentacionit arkivor, janë kryer edhe punë të tjera sipas planit të punës .

Rinia

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar këto aktivitete kryesore në Qendren Rinore Publike .

Organizimi i trajnimeve /workshopeve për të rinjtë (temat lidhshpë,aktivizëm rinor,vullnetarizime)

Mbështetje e organizatave rinore dhe grupeve jo formale

Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe edukative për të rinjtë

Bashkëpunimi me OJQ lokale etj.

-20 Korrik 2025- “Muaji i Diasporës” është organizuar nga Komuna e Skenderajt, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport. Për nder të Muajit të Diasporës Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport mbajtën një mori aktivitete për t’i argëtuar bashkatdhetarët tanë nga Diaspora.

Çdo natë për argëtimin e qytetarëve të Skenderajt dhe me gjerë, sidomos për qytetarët nga Disapora që ishin për pushime në vendlindje, janë përgatitur mbrëmje muzikore me shumë këngëtare të mirënjohur nga estrada kosovare. Në këtë aktivitet për gjatë gjithë muajit kanë marrë pjesë rreth 100 mijë qytetarë.

Aktivitetet “Ditët e Mergatës” janë përmbyllur me datën 14 Gusht.

-Shtator – vizita te shumta te shkollave te qytetit dhe qytetareve në Muzeun e Qendrës se Kulturës “ Hasan Prishtina “ për ti parë nga afer artefaktet dhe eskonatet e muzeut tonë.

-03 Tetor - Shfaqja e dramës Magjia e leximit. Ky aktivitet u mbajt në sallën e Qendrës se Kulturës dhe kishte perafërsisht 300 femijë pjesëmarres dhe te fluar. Ky aktivitet është mbajtur në bashkëpunim me UNICEF dhe një Ojq për promovimin e leximit.

07 tetor 2025- U bë thirrja publike për organizimin e Festivalit Gjithëkombetar “ Rapsodia Shqiptare” edicioni i 20-të.

06 nëntor – u publikua lista perfundimtare nga thirrja publike e muajit tetor 2025 për Organizimin e Festivalit Gjithëkombetar “ Rapsodia Shqiptare “ edicioni i 20-të

25 nëntor 2025 –Shfaqje artistike nga Ansambli Artistik “ Nëna Terezë – Tiranë në Qendrën e Kulturës “ Hasan Prishtina”

-Me 26, 27 dhe 28 Nëntor 2025 - Për nder të këtyre datave historike DKRS-ja përkatësisht Sektori për Kulturë organizon Festivalin Folklorik, Gjithëkombëtar “Rapsodia Shqiptare” edicionin e 20-të,

Me datë 13.10.2025 është formuar Bordi i Festivalit Folklorik “ Rapsodia Shqiptare”.

Anëtarët e këtij bordi janë:

1. Alban Berisha, Drejtor i Festivalit.
2. Faton Zekaj, anëtar,
3. Xhevat Dervishi, anëtar,
4. Bleard Osmani, anëtar
5. Imer Loshi, anëtar
6. Albert Lushtaku, anëtar
7. Valbona Hoti, sekretare
8. Fehmi Lushtaku anëtar
9. Valentina Hylenaj Bimbashi anëtare
10. Albulena Lushtaku Ahmetaj, anëtare
11. Fehmi Ymeri, anëtar
12. Shehrije Geci , anëtare
13. Burim Feka, anëtar
14. Bashkim Meha, anëtar

Mbledhja e parë për festivalin folklorik “Rapsodia Shqiptare” e mbajtur me 20.10.2025 me drejtorin e DKRS-së dhe gjithë Bordin Organizativ, pas shumë diskutimesh rreth organizimit të festivalit, u caktuan edhe sektorët e bordit dhe sekretari i Festivalit. Gjithsej janë mbajtur 6 mbledhje te Bordit.

Në garën e Festivalit Folklorik Gjithëkombëtar “Rapsodia Shqiptare” Skenderaj 2025.

Nata e parë konkurruese 26 Nëntor 2025, kanë konfirmuar pjesëmarrjen. 16 grupe,

Nata e dytë konkurruese 27 Nëntor 2025, kanë konfirmuar pjesëmarrjen 15 grupe

Në natën e tretë konkurruese 28 Nëntor 2025 – nata finale e festivalit kanë performuar 16 grupe.

- 28 Nëntor 2025 - Festivali Folklorik Gjithëkombëtar “ Rapsodia Shqiptare” Qendra e Kulturës “ Hasan Prishtina” edicioni i 20-të. Nata finale e këtij festivali ku u shpallen dhe fituesit te cilet moren edhe çmime, vlenë te theksohet se ky është event i me i madh kulturor i organizuar nga komuna e Skenderajt gjeqësisht nga Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport i cili i dedikohet festave të Nëntorit dhe figurës se Heroit kombëtar Hamëz Jashari . Çmimi Kryesor është “ Kulla e Jashareve “ të cilin e fituan rapsodet e mirënjohur Jeton dhe Tefik Fetiu nga Kamenica . Në këtë event për tri net radhazi morën pjesë mbi 1000 shikues. Për këtë aktivitet DKRS ka ndarë 22,000.00 (njëzet e dymijë euro).

- 28 nëntor - Ceremonia e zbulimit te busteve te Sala dhe Hamit Jashari në Institucionin Parashkollor.

-28 Nëntor- Homazhe në Kompleksin memorial Adem Jashari dhe në Marinë.

-28 Nëntor – Ceremonia e zbulimit të Obeliskut “ UÇK “ në sheshin “ Adem Jashari “ si dhe Ceremonia e zbulimit të Muralit “Vallëzimi i Nëntorit “ tek oborri i Qendrës së Kulturës.

- 28 Nëntor - Perfundimi i “Vrapimit të Nëntorit“ 28 kilometra, ndarja e çmimeve për fituesit e garës në Sheshin “Adem Jashari” në këtë aktivitet moren pjesë afërsisht 250 persona.

- 10 Dhjetor- Ndezja e dritave të fundvitit në komunën tonë.

-30 Dhjetor darka e fundë vitit me puntorët e administratës komunale të Komunës-Skenderajt.

-31 Dhjetor 2025 me rastin e festës së Vitit të Ri në Sheshin “Adem Jashari” në Skenderaj në ora **12:00** janë ndezurë fishekë zjarrët.

Tabela e të dhënave për vitin 2025:

Hapësira për aktivitete të sportit për numër të banorëve	87997 m2.
Numri i aktiviteteve kulturore rinore dhe sportive të organizuara me buxhet komunal këtë vit	Kulturore: 67 Rinore: 10 Sportive: 7 Totali: 84 aktivitete